

**MBLEDHJA E KUVENDIT TË KOSOVËS****Mbajtur më 4.3.2002 në Prishtinë****KRYETARI NEXHAT DACI**

Kolegë të nderuar deputetë, më lejoni të hap vazhdimin e seancës së parë. Në ndërkohë prej takimit të fundit dhe vazhdimin që do ta bëjmë sot, Parlamenti i Kosovës ka humbur një nga deputetët e tij, prandaj, ju ftoj që me një minutë heshtje, të bëjmë nderimin deputetit të Parlamentit z. Smajl Hajdaraj.

Lavdi,

Prandaj, në vazhdim të seancës të papërfunduar duhet të bëjmë kompletimin e Kryesisë së Parlamentit të Kosovës. Me datën 28 janar 2002 nga udhëheqësi i grupit parlamentar, të grupit të dytë për kah numri i ulëseve në parlament të PDK-së ka ardhur propozimi dhe nominimi i dy anëtarëve për Kryesi të Parlamentit të Kosovës, këta janë z. Xhavit Haliti dhe Hydajet Hyseni,

Të nderuar deputetë të Kuvendit, sipas kornizës Kushtetuese dhe Rregullorës së punës të Kuvendit nga ne kërkohet t'i miratojmë këto emëtime me miratim formal, dmth që unë do të ftoj që me pëlqimin tonë të votojmë për anëtarët e nominuar nga PDK-ja. Ju ftoj të ngrehim dorën, kush është për t'i zgjedhur anëtarë të Kryesisë zotëritë Xhavit Haliti dhe Hydajet Hysenin.

A ka dikush që voton kundër, asnjë votë kundër, ju falemnderit, a ka dikush që abstenon, ju falemnderit,

Prandaj më lejoni që anëtarëve të rinj të Kryesisë së Kuvendit t'ju dëshiroj mirëseardhje dhe urime për punën e tyre të mëtejshme. Dhe me këtë votim është kryer votimi i Kryesisë së Parlamentit të Kosovës me 7 anëtarë. Tani kalojmë në procedimin e mëtejshëm të agjendes së seancës së filluar dhe për këtë, siç e dini, gjatë javëve të kaluara ka qenë një aktivitet i bujshëm dhe përfundimisht shumë i frytshëm për marrëveshjen e arritur. Mirënjohje të veçanta u shkojnë kryetarëve të partive politike që kanë grupet më të mëdha në Parlamentin e Kosovës Z. Ibrahim Rugova, z. Hashim Thaçit dhe z. Ramush Haradinaj, Por të mos e harrojmë, ai që e dha shenjën që do ta mbajmë gjatë në këtë

marrëveshje që bëni shumë mund dhe që ishte shumë dinamik joanues me bindje të thellë të them me të drejtë ishte përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm Z. Kofi Anan. Z. Mihajl Shtajner të cilin e ftoj që t'i thotë disa fjalë për marrëveshjen,

**Z. MIXHAEL STEINER**  
**KRYEADMINISTRATOR I KOSOVËS**

Z. Kryetar, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, vërtet jam i lumtur që gjendem sot këtu para jush.

Javën e kaluar pas një varg bisedimesh intenzive, u arrit një marrëveshje për Presidentin dhe Qeverinë e Kosovës, në frymën e kompromisit udhëheqësit tuaj kanë arritur një marrëveshje të shumëpritur, jam i bindur se kjo marrëveshje mund të shërbejë si një themel i një të ardhme më të mirë për Kosovën. Roli im në këtë proces ishte thjeshtë që të shërbej si lehtësues dhe dëshmitar i marrëveshjes, ju tejkaloat bllokadën politike.

Sot është një ditë e rëndësishme në historinë e Kosovës. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara e ka përshëndetur përzemërsisht marrëveshjen e arritur, Kofi Anan kërkon nga ju që ta shfrytëzoni atë siç duhet dhe ta formoni qeverinë menjëherë.

Ky Kuvend është mbledhur sot për ta vulosur marrëveshjen. Deputetët e Kuvendit e kanë marrëveshjen para vetes, prandaj unë vetëm do t'i përmbledh elementet kyçe. Së pari parimet e përgjithshme, liria e të shprehurit për të gjithë në Kuvend, trajtimi i drejtë dhe i barabartë për të gjithë banorët e Kosovës dhe pajtimi dhe toleranca ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Kosovë,

Së dyti, prioritetet e qeverisë, konsolidimi i strukturave demokratike, rritja e efikasitetit të transparencës, përmirësimi i standardeve të shkollimit për të gjithë, rritja e cilësisë së shëndetësisë publike për të gjithë, nxitja e zhvillimit ekonomik, shtimi i vendeve të punës, ofrimi i pensioneve dhe ndihmave sociale të grupeve të rrezikuara dhe integrimi i të gjitha komuniteteve të Kosovës.

Së treti, kompetencat dhe përgjegjësitë, kandidati i caktuar nga LDK-ja Dr. Ibrahim Rugova do të jetë Kryetar i Kosovës, sipas marrëveshjes kandidati i caktuar nga PDK-ja Dr. Bajram Rexhepi do të jetë Kryeministër. Me propozimin e Kryeministrit do të ketë 10 poste ministrore duke e përfshier edhe ministrinë e sapoformuar të Mjedisit të

Planifikimit Hapësinor, listën e ministrave, sipas propozimit të Kryeministrit e keni para vetes, emri i Ministrit të Bujqësisë Pylltaris dhe Zhvillimit Plural e ka marrë nga deputeti serbë të Kuvendit në zyren time me 2 mars nuk është konfirmuar ende.

Në marrëveshje është rrënë dakordë që gjithashtu që zëvendësimi i ndonjë ministri të bëhet nga një ministër të bëhet subjekt politik. Asnjë ministër nuk do të shkarkohet pa pëlqimin e përfaqësuesit special të Sekretarit të Përgjithëm të Kombeve të Bashkuara.

Së fundi zbatimi i kësaj marrëveshjeje.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës Akademik Nexhat Daci ,do të ju lus që të votoni për konstituimin e institucioneve të përkohëshme në bazë të kësaj marrëveshjeje e cila gjendet para jush.

Nënshkruesit e marrëveshjes janë marrë vesh që të votohet e tërë pakoja me anë të një votimit të vetëm të hapët . Duke votuar për këtë marrëveshje do të zgjedhni Kryetarin e ardhshëm por njëkohësisht do të formoni edhe qeverinë e re të Kosovës. Vota e jua për këtë marrëveshje është votë për të ardhmen e Kosovës, Ju falemnderit.

**Z.Nexhat Daci,** *Nexhat Daci*

Z. Shtajner në emër të parlamentit të Kosovës një falemnderim të sinqertë me eqenëse hapat e parë janë të sukseshme.

Kolegë të nderuar deputet, zonja dhe zotërinjë, i dëgjuat kushtet e marrëveshjes, propozohet që Kuvendi të votoi për mbajtjen e saj me një votim të vetëm të hapur të, gjitha njohtimet që vijnë sugjerojnë se vendimi i tillë i Kuvendit në mbështetjen dominuese të deputetëve është në përputhje juridike dhe me frymën e kornizes Kushtetuese, prandaj nëse pajtoheni procedojmë me votim.

**NEXHAT DACI** *Nexhat Daci*

**Urdhëroni Z. Saviq**

Gospodine Predsedniče, dragi kolege, ja bih najpre uputio na jedno pitanje da to razjasnimo da li ćemo ovim glasom glasati samo za Predsednika Kosova ili ćemo glasati za kompletan sporazum .

**Z. NEXHAT DACI** *Nexhat Daci*

Për tërë marrëveshjen, votomë për marrëveshjen në tërësi z. Saviq.

**Gojko Savić**

Z. Savić, ja moram da pođem da saslušam prevod, samo trenutak, dnevni red, najpre ovaj poziv koji smo mi poslanici Koalicije Povratak koji smo dobili, stoji da će se u ponedeljak 4 marta 2002 godine u 11 sati održati u Sali Skupštine, znači Skupština a u prilogu se nalazi dnevni red za sastanak, u dnevnom redu ,stoji nastavak inagurativne sednice što znači nastavak sednice koje smo započeli još prej nekoliko meseci, ja imam pred sobom inegurativne zasedanje Skupštine Kosova koje započeto 10. 12.2001 godine gde je dnevni red sledeći. Izjava vršioca dužnosti predsedavajući na konstutuisanje Skupštine to smo završili, sednica skupštine, ovoga trenutka smo dobili još dva člana predsedništva , treća tačka zvanični i inaguralni govor predsednika Skupštine, i to je bilo sećate se, i četvrta je izbor predsednika Kosova, to znači pošto mi nastavljamo inagurativnu sednicu mi danas po pravilniku imamo pravo samo da biramo Predsednika Kosova.

Falemnderit,

**KRYETARI I KUVENDIT**

**NEXHAT DACI,**

Unë mendoj që nuk kemi brenga të tjera në Parlament, mund ta kuptoj brengën e z. Saviq, të gjitha bisedat që janë zhvilluar kanë ardhurë në përfundim nga të gjithë ekspertët juridikë dhe politikë, që ajo që është propozuar nga Z. Shtajner i takon të gjitha kërkesat megjithate ne që jemi në fillim të procesve demokratike dhe me një bindje të thellë që jemi institucion demokratik ju ftoi që me votë të hapur të përcaktohem i kush është për procedurën që na i spjegoj dhe inicoj përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm z. Shtajner le ta qojnë dorën, ju falemnderit, kush është kundër, asnjë votë kundër, prandaj procedojmë, një votë kundër, me zgjedhjen në pako ashtu si e parashefë marrëveshja të Kryetarit të Kosovës Dr. Ibrahim Rugova të Kryeministrit të Kosovës Dr. Bajram Rexhepi, dhe të tërë qeverisë të paraqitur në këtë marrëveshje, kush është pro? Ftojë anëtarët e respektuar të këtij parlamenti, kusht është kundër marrëveshjes t'i ngritin duartë? Dhe së fundi, a ka dikush nga deputetët e parlamentit që ka abstenuar nga votimi.

Për procesin e votimit do t'ju informoj se për marrëveshjen në tërësi kanë votuar 88 anëtarë të Parlamentit të Kosovës, Z. Shtajner ju falemnderit, kundër marrëveshjes ishin 3 anëtar të Parlamentit të Kosovës, kanë abstenuar 15, prandajë e shpalli të përkrahur dhe të aprovuar marrëveshjen e negociuar dhe të nënshkruar, dhe ju informoj se Kuvendi miratoj zgjedhjen e Dr. Ibrahim Rugovës për Kryetar të Kosovës, të Dr. Bajram Rexhepit për Kryeministër të Kosovës, prandaj më lejoni që edhe zyrtarisht të shpallë.

### ***KRYETAR TË KOSOVËS DR. IBRAHIM RUGOVA***

Kryeministër, Bajram Rexhepin, në të njejtën kohë më lejoni ti shpallë emrat e ministrave të zgjedhurë të Qeverisë të Kosovës, e këta janë:

Ministër të Financave dhe të Ekonomisë z. Ali Sadriu

Ministër të Tregtis dhe Industrisë Prof. Ali Jakupi

Ministër të Arsimit Shkencës dhe Teknologjis Z. Rexhep Osmani

Ministër të Kulturës dhe Sporteve Z. Rexhep Blakqori

Ministër të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapsinor Z. Hetem Qeku

Ministër të Punës dhe Mirëqenis Sociale z. Ahmet Isufi

Ministër të Transportit dhe Komunikacionit z. Zef Morina

Ministër të Shërbimeve Publike z. Jakup Krasniqi

Ministër i Shëndetësisë z. Numan Baliq

Në emër të Kuvendit të Kosovës anëtarëve të sapo zgjedhur të institucioneve të përkohëshme të qeverisjes në Kosovë u shpreh urimet e mia më të përzemërta,

Në emër të Kuvendit, por mendoj se flas, dhe në emër të tërë popullit të Kosovës ,ju dëshirojë çdo të mirë shëndet dhe shumë shumë punë, Kosova ka besim ne ju,do ta keni përkrahjen e plotë të parlamentit, prandaj urime..

Ftoi Kryetarin e Kosovës Dr. Ibrahim Rugova, Kryeministrin e Kosovës Dr. Bajram Rexhepin dhe të gjithë ministrat që të dalin në medium para jush dhe para Kuvendit.

Seanca shpallet e përfunduar,